



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK**

PROÇESVERBAL

Nr. 10, datë 21.06.2023

**I mbledhjes së parë të Këshillit Bashkiak Durrës të dalë nga zgjedhjet e datës
14 maj 2023, që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak**

Orari i fillimit të mbledhjes : 10:00

Data e mbajtjes së mbledhjes : 21.06.2023

Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak

Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e konstitumit të këshillit bashkiak.

Të ftuarit : Prefekti i qarkut Durrës, deputet, kryetar të partive përfaqësuese në këshill (dega Durrës), përfaqësues të drejtorive pranë bashkisë, media, OJF.

Dorina Milja: Përshëndetje !

Mbajmë sot mbledhjen e parë të Këshillit Bashkiak të dalë nga zgjedhjet e 14 Majit.

Do të merrni sot një detyrë të rëndësishme në interes të qytetit dhe qytetarëve.

Ju uroj suksese dhe punë të mbarë në këtë mision të rëndësishëm.

Po kaloj në leximin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, me nr.649, datë 02.06.2023 ”Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për këshillin e bashkisë Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka vendosur :

Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Durrës, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	13
Partia Socialiste e Shqipërisë	28
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	3
Partia Socialdemokrate	1
Partia Demokratike	5
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	1

Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për Këshillin e Bashkisë Durrës, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1.	Ardian	Mihal	Muka
2.	Edlira	Tahir	Shemsi
3.	Luan	Ramazan	Nezha
4.	Kontjana	Vasil	Kuçi
5.	Dritan	Eqrem	Burgija
6.	Manjola	Ramiz	Luku
7.	Ermal	Bujar	Braholli
8.	Zhuljeta	Haxhi	Ngota
9.	Arlind	Kristaq	Boshku
10.	Arjeta	Ermir	Keçi
11.	Bledar	Ramadan	Prizreni
12.	Anisa	Ilir	Ibraj
13.	Erzen	Agim	Laçi

Partia Socialiste e Shqipërisë

1.	Rolant	Hamdi	Xhelilaj
2.	Ana	Vladimir	Dhamo
3.	Ani	Luan	Dyrmishi
4.	Xhiliola	Raimondo	Doçi
5.	Munir	Selim	Konesha
6.	Alneida	Nexhmi	Rroshi
7.	Alfred	Fazlli	Mullaraj
8.	Jonada	Manush	Mamo
9.	Jurgen	Luan	Zaza
10.	Elisabeta	Sherif	Mataj
11.	Ervis	Rexhep	Bekteshi
12.	Suada	Bujar	Çurri

13.	Denis	Alban	Lika
14.	Alketa	Islam	Ngjeçi
15.	Ilir	Sefer	Paja
16.	Klementina	Kadri	Meçi
17.	Llesh	Preng	Çuni
18.	Anila	Enver	Kapidani
19.	Franc	Mojsi	Tragaj
20.	Nurije	Luan	Gjoni
21.	Hekuran	Vlash	Markola
22.	Silvana	Lazi	Agasi
23.	Aldo	Kudret	Çelaj
24.	Denisa	Ibrahim	Luarasi
25.	Dorian	Besim	Isaj
26.	Marsida	Pullumb	Feshti
27.	Dritan	Shpetim	Rakipi
28.	Joniada	Musa	Musaraj

Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë

1.	Erald	Avni	Dalipi
2.	Xhojana	Abedin	Gjineci
3.	Renald	Leonard	Koka

Partia Socialdemokrate

1.	Flutura	Isuf	Kasa
----	---------	------	------

Partia Demokratike

1.	Jonuz	Hasan	Myshketa
2.	Edlira	Novruz	Devolli
3.	Sami	Shiqer	Osmani
4.	Blerina	Niazi	Reçi
5.	Samet	Basri	Vata

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet

1.	Florian	Kujtim	Tahiri
----	---------	--------	--------

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ju uroj dhe njëherë suksese !

Fjalën e merr prefekti i qarkut Durrës z. Emiljan Jani .

Emiljan Jani : E nderuar znj.Sako ! Të nderuar deputetë! Të nderuar anëtarë të këtij këshilli bashkiak dhe të gjithë ju pjesëmarrës !

Jam i lumtur që ndodhem këtu mes jush sot, për të zhvilluar mbledhjen e parë të këtij Këshilli, i cili do të vijojë punën e tij për katër vitet e ardhshme të mandatit. Jam i bindur se ky Këshill që konstituohet sot do të përfaqësojë me përgjegjësi të lartë interesat e të gjithë komunitetit nën juridiksionin e tij. Vendimmarja juaj për katër vitet e ardhshme, do të jetë thelbësore në zhvillimin dhe mirëqenien e këtij qyteti. Vendimet që ky këshill do të shtrojë për diskutim dhe do të miratojë, prekin çdo qytetar, duke filluar nga ata më të vjetërit dhe deri tek ardhmja e këtij qyteti, që janë fëmijët tanë. Do të doja nga ju që në çdo çast të kryerjes së detyrës suaj shumë të rëndësishme, të mendoni për fëmijët dhe qytetin që duam dhe duhet t'ju lemë trashëgim atyre. Fëmijët tanë meritojnë një qytet europian dhe të tillë qeverisje jemi të detyruar ne t'ju sigurojmë.

Znj. Sako duke ju uruar suksese për punën tuaj në vazhdim, nuk mund të le pa përmendur punën e dukshme të bërë në këtë qytet gjatë mandatit të kaluar. Bashkëpunimi dhe konsultimi me ju nuk ka munguar, me qëllimin e vetëm të zgjidhjes së problemeve të përbashkëta të hasura gjatë punës sonë. Jam i bindur se Durrësi në katër vitet e ardhshme me ju, do të jetë një destinacion turistik akoma më i frekuentuar. Jo vetëm turistët, por edhe çdo banor i këtij qyteti do të gjejë tek ju gjithmonë dyer të hapura dhe një shërbim të standarteve europiane.

Në përfundim, për të vazhduar procedurat ligjore të konstituimit të këshillit bashkiak të Durrësit ju uroj të gjithëve suksese në detyrën tuaj shumë të rëndësishme të besuar nga ky qytet.

Në bashkëpunim me qeverisjen qendrore jam i bindur se ky Këshill Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë do të kenë në kryefjalën punës së tyre qytetarin, fëmijët, të ardhmen .

Ju faleminderit!

Dorina Milja : Në bazë të nenit 48, pika 5 të ligjit 139/2015 “Për vetqeverisje vendore” i ndryshuar, ftoj kandidatin për këshilltar më të vjetër në moshë të drejtoj mbledhjen e parë deri në zgjedhjen e kryetarit të këshillit, z.Rolant Xhelilaj i datëlindjes 1956.

Rolant Xhelilaj : Ju përshëndes !

Faleminderit znj. Sekretare për më të vjetërin në moshë, por ligji e ka, rregulli e ka, duhet ta pranojmë, por mund të gjehej një më e butë, kështu si “këshilltari më i vjetër”, sepse rikthehem në këshillin bashkiak pas 10 vjetësh. Duke qenë prej shumë vitesh anëtar i këshillit bashkiak, ekziston e drejta ime që të drejtoj mbledhjen nga dy drejtimet, edhe moshës, edhe përvojës. Megjithatë kënaqësi që më jepet mundësia të drejtoj mbledhjen e parë të këshillit, sepse më jep një kënaqësi paraqitja e gjithë anëtarëve të këshillit bashkiak sot këtu, të ri, por dhe mosha jonë apo afër moshës sime, që besoj se do të bëjmë gjënë më të mirë për qytetin e Durrësit.

Si fillim falenderoj pjesëmarrësit që na nderojnë sot, Deputetët, Kryetarin e Partisë Socialiste Durrës, nga forcat e tjera nuk e di kush janë, pasi kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e zgjedhjeve, në zgjedhjet e këtij këshilli bashkiak.

Falenderoj Prefektin dhe në radhë të parë uroj Anin që në vazhdim të mandatit të suksesshëm merr një mandat tjetër të rëndësishëm, të vështirë, por që besoj me ne bashkë të gjithë me një qëllim të vetëm do të bëjmë më të mirën për Durrësin, duke vënë në plan të parë interesin për

qytetarët, patjetër më debat, me opinione, me propozime sipas këndvështrimeve tona sipas forcave politike që përfaqësojmë, por në themel besoj dhe jam i bindur që do të jetë interesi qytetarit. Këtë e kam bindje sepse në këtu përfaqësojmë qytetarët e Durrësit që më kulturë e tyre na japin mësim e parë ne, me mënyrën e sjelljes para zgjedhjeve e pas zgjedhjeve, kështu që ne jemi të detyruar të reflektojmë me atë kulturë që ka qyteti i Durrësit dhe besoj se për gjërat e rëndësishme do të jemi unanimit për të mirën e qytetarëve. Për të gjithë problemet e tjera debati do të jetë qytetar dhe besoj se do të ekzistojë një frymë mirëkuptimi për më të mirën për ne, për familjet tona, për qytetin. Do japim shembullin pozitiv për gjithë Shqipërinë.

Mua më ngarkohet detyra të drejtojë mbledhjen e parë të konstituimit dhe këtu sipas rregullit duhet ta nis sipas procedurës që është shkruar këtu.

Në fillim do të përcaktojmë komisionin e verifikimit të mandateve. Komisioni është përcaktuar?

Dorina Milja : Jo, do të përcaktohen këtu.

Rolant Xhelilaj : Do bëhen propozime këtu?

Dorina Milja : Po.

Rolant Xhelilaj : Atëherë propozimet të bëhen këtu, të bëjmë vlerësimin e mandateve për të kaluar pastaj në gjithë pikat e tjera.

Dorina Milja : Dy i përcakton grupi shumicës dhe një opozita. Kryetarët e grupeve të bëjnë propozimet.

Rolant Xhelilaj : Do bëjmë dhe prezantimet për kryetar grupi. Kryetar grupi për Partinë Socialiste jam unë dhe në këtë rast do t'i bëj të dyja drejtimin e mbledhjes dhe propozimin e kandidatëve.

Jonuz Myshketa : Kryetar grupi për Partinë Demokratike jam unë.

Dritan Burgija : Nga koalicioni propozojmë për anëtar komisioni z. Luan Nezha.

Rolant Xhelilaj : Alneida propozoi ti sot, meqë jam këtu.

Alneida Rroshi : Përshëndetje !

Partia Socialiste propozon për Komisionin e Mandateve Ana Dhamo dhe Aldo Çelaj.

Rolant Xhelilaj : Joni.

Jonuz Myshketa : Propozojmë zj. Blerina Reçi.

Rolant Xhelilaj : Tani si rregull komisioni do të jetë më 5 apo me 3 se u bëmë 4.

Dorina Milja : Me tre.

Rolant Xhelilaj : Atëherë midis këtyre dy forcave. Joni na vjen keq, po i takon pjesës tjetër të ketë anëtar në Komisionin e Mandateve.

Anëtarët e komisionit të verifikimit të mandateve të dalin të zënë vend tek tavolina këtu.

**.....Komisioni i verifikimit të mandateve zënë vendet dhe fillojnë nga puna për verifikimin e mandateve të kandidatëve për këshilltarë të pranishëm në sallë. I vihet në dispozicion nga sekretarja e këshillit dokumentacioni.....*

Ana Dhamo : Thërret një e nga një emrat e kandidatëve për këshilltarë të pranishëm në sallë. Dori të ka njoftuar zonja që mungon.

Dorina Milja : Jo, nuk më ka njoftuar. Vetëm Sami Osmani, që ju dhashë email. Prandaj thashë bëni apelin se pashë karrige bosh.

Ana Dhamo : Komisioni i mandateve pasi bëri apelin dhe shfletoi dokumentacionin për kandidatët e pranishëm në mbledhjen e konstituimit të këshillit bashkiak konstatoi se : Në mbledhje marrin pjesë 49 këshilltarë dhe nuk marrin pjesë 2 , ku njëri prej tyre ka njoftuar me mjete të komunikimit elektronik mungesën e tij.

Pra, vërtetohet vlefshmëria për 49 këshilltarë të këshillit bashkiak në ditën e sotme.

Ju ftoj të votojmë raportin.

Rolant Xhelilaj : Kalojmë në votim. Kush është dakort? 49 pro. Faleminderit Komisionit.

Ana Dhamo : Suksese të gjithëve.

Rolant Xhelilaj : Dy anëtarët e tjerë të betohen në mbledhjen tjetër.

Tani do të lexoj formulën e betimit dhe secili prej jush do të ngrihet në këmbë dhe do thotë ”Betohe”.

“Betohe në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohe se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Ardian Muka deri te Florian Tahiri : BETOHEM .

Rolant Xhelilaj : Urime zyrtarisht atëherë për detyrën dhe sukses në punën e mandatit tuaj. Faleminderit .

Do të nënshkruani secili dokumentin që keni në dosjen Tuaj (*Formula e betimit*).

Do të kalojmë në një pikë tjetër në zgjedhjen e Kryetarit të këshillit.
Propozimet do t'i bëj unë në emër të grupit të Partisë Socialiste.
Grupi i Partisë Socialiste propozon për kryetar këshillit z. Ani Dyrmishi për vazhdim të një 4-vjeçari të suksesshëm si dhe kandidon për kryetar dhe z.Aldo Çelaj.
Do të zgjedhim një Komision Votimi.
Alneida....

Alneida Rroshi : Për Komisionin e Votimeve nga grupi Partisë Socialiste propozojmë Klementina Meçi dhe Denis Lika.

Rolant Xhelilaj : Dritan do të keni apo do ja lësh Jonit.

Dritan Burgija : Propozojmë Ardian Muka.

Rolant Xhelilaj : Komisioni të zër vendin.

Të ftuarit ju krijojmë mundësinë të pinë një kafe, meqenëse pjesa e votimit do të jetë aty dhe do të mbyllet salla gjatë votimit.

**....Nis procesi i votimit për kryetarin e këshillit. Secili këshilltarë firmos, merr fletën e votimit dhe voton. (votimi është i fshehtë).*

Në përfundim të votimit komisioni vazhdon punën për numërimin e fletëve të votimit dhe plotësimin e procesverbalit.....

Klementina Meçi : Komisioni pas shqyrtimit dhe numërimit të votave doli në konkluzionin që: Kanë votuar 49 këshilltarë dhe respektivisht shpallet kryetar këshilli z. Ani Dyrmishi me 40 vota dhe 9 vota të tjera janë të pavlefshme.
Faleminderit .

**.... Duartrokitje nga të pranishmit...*

Rolant Xhelilaj : Duke qënë se pata mundësinë të drejtoj mbledhjen, na jep mundësinë të të urojmë. Ani Dyrmishi është kryetar këshilli për këtë mandat. Të urojmë suksese dhe të ftoj të zesh vendin.

**... Ani Dyrmishi i jep dorën kandidatit tjetër z. Aldo Çelaj.....*

Ani Dyrmishi : Në radhë të parë faleminderit të gjithëve si pozitës dhe opozitës. Besoj se gjatë këtij mandati do të kemi një bashkëpunim shumë të mirë duke qënë se Durrësi është një qytet që mbahet për qytetari dhe besoj se do shkoj çdo gjë në zbatim të ligji dhe rregullores së këshillit. Ju faleminderit !

Nuk po zgjatem më pasi dhe parafolësit i thanë të gjitha faleminderimet kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës përse i përket procedurës së zgjedhjes së zëvendëskryetarëve.

Kërkoj nga kryetarët e grupeve të propozojnë për numrin e zëvendëskryetarëve që do të ketë këshilli bashkiak.

Rolant Xhelilaj : Ne grupi i Partisë Socialiste propozojmë që numri i zëvendëskryetarëve të jetë 2 (dy). Një nënkryetar nga ne dhe një nënkryetar nga opozita.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Dritan Burgija : Bim dakort me numrin 2 (dy).

Ani Dyrmishi : Atëherë e hedhim në votim. Kush është pro për zgjedhjen e 2 zëvendëskryetarëve në këshillin bashkiak ?

Kundra ? ... Abstenim?..... nuk ka .

Me 49 vota pro miratohet funksionimi i kryesisë më 2 zëvendëskryetar.

Kalojmë në propozimet për kandidatët për zëvendëskryetar.

I jap fjalën grupit të opozitës.

Dritan Burgija : Propozojmë z. Ardian Muka për nënkryetar të këshillit bashkiak.

Ani Dyrmishi : Duhet dhe një propozim tjetër femër.

Dritan Burgija : Atëherë zonjën Edlira Shemsi.

Jonuz Myshketa : Besoj se na takon dhe ne për propozim të zëvendëskryetarit.

Ani Dyrmishi : Po.

Jonuz Myshketa : Në emër të kryetarit të grupit të Partisë Demokratike propozojmë znj.Edlira Devolli për nënkryetare të këshillit bashkiak.

Ani Dyrmishi : Ok. faleminderit.

z. Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj : Në emër të grupit të Partisë Socialiste propozojmë znj. Ani Rroshi dhe Silvana Agasi.

Ani Dyrmishi : Ok. faleminderit.

Atëherë komisioni i votimit të filloj procedurën e votimit.

**.... Secili kryetar grupi plotëson procesverbalin me emrat e propozuar prej tyre, që të përgatiten fletët e votimit.....*

**.....Në komisionin e votimit ndërrohet këshilltari Ardian Muka me këshilltaren Anisa Ibraj,*

pasi është kandidat për zëvendëskryetar të këshillit.....

Klementina Meçi : Procedura është e tillë. Do të keni dy fletë votimi. Tek njëra janë 2 kandidatët nënkryetar nga pozita dhe tjetra tre kandidatët për nënkryetar nga opozita.

Ani Dyrmishi : Fillon procesi i votimit dhe ftoj të gjithë këshilltarët me radhë të votojnë.

**...Nis procesi i votimit për zëvendëskryetarët e këshillit. Secili këshilltarë firmos, merr fletët e votimit dhe voton. (votimi është i fshehtë).*

Në përfundim të votimit komisioni vazhdon punën për numërimin e fletëve të votimit dhe plotësimin e procesverbalit.....

Klementina Meçi : Atëherë komisioni ka dal në konkluzion :

Për zëvendëskryetarin e propozuar nga Partia Socialiste në votim morën pjesë 48 këshilltarë, fletë votimi ishin 48, nga të cilat 37 të vlefshme dhe 11 të pavlefshme. Konkretisht,

- znj. Alneida Rroshi mori 35 vota dhe
- znj. Silvana Agasi mori 2 vota.

Suksese znj. Rroshi.

**... Duartrokitje nga të pranishmit...*

Përsa i takon kandidatëve të opozitës, morën pjesë në votim 48 këshilltarë, nga të cilat 48 fletë u gjetën në kuti,

- z. Ardian Muka ka marrë 7 vota,
- znj. Edlira Shemsi ka marrë 9 vota dhe
- znj. Edlira Devolli ka marrë 32 vota.

Suksese znj. Devolli.

**... Duartrokitje nga të pranishmit...*

Faleminderit .

Ani Dyrmishi : Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës.

Është pika e betimit të Kryetarit të Bashkisë.

Atëherë më Vendimin nr.11-2023-3024/114, datë 08.06.2023 Gjykata e Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm Durrës ka vendosur :

Në bazë të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 60 të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“.

1. Pranimin e kërkesës së kërkueses znj. Emiriana Hiqmet Sako.
2. Vërtetimin e mandatit të Kryetarit të Bashkisë znj. Emiriana Hiqmet Sako, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore (Kryetar Bashkie) të datës 14 maj 2023, sipas Vendimit nr.644, datë 02.06.2023 të KQZ, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

U shpall në Durrës me datë 08.06.2023.

Znj.Sako ju ftoj të ngriheni në këmbë, unë do lexoj formulën e betimit, ju do të thoni ”Betohe”.

“Betohem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e kryetarit të bashkisë dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Betohem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të Bashkisë Durrës dhe do të punoj me ndershmëri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Emiriana Sako : Me dorën në Kushtetutë ”BETOHEM”.

**.... Duartrokitje nga të pranishmit...*

**.....Kryetari i këshillit vendos shiritin kryetares së bashkisë Durrës znj. Emiriana Hiqmet Sako.....*

..... Të gjithë në këmbë luhet Himni Kombëtar....

Ani Dyrmishi : Ftoj Kryetaren e Bashkisë Durrës të mbaj fjalën përshëndetëse.

Emiriana Sako : Faleminderit të gjithëve.

Uroj gjithë këshilltarët sot, kryetarin dhe 2 zëvendëskryetarët e sapozgjedhur, suksese.

Ka qenë një sfidë e madhe përballë qytetarëve të Durrësit, kemi marrë një angazhim të madh. Si sot dhe ditën e fundit të këtij mandati unë do të kem impenjimin më të madh për të realizuar ato premtime që i kemi bërë qytetarëve. Sigurisht 4 vite nuk janë shumë, por janë mjaftueshëm për të qenë gjithë së bashku bashkëudhëtarë për zhvillimin e qytetit tonë drejt një qyteti europian.

Faleminderit të gjithëve dhe suksese.

**.... Duartrokitje nga të pranishmit...*

Ani Dyrmishi : Faleminderit Kryetare. Suksese dhe ju.

Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës përsa i përket zgjedhjes së përfaqësuesve të këshillit bashkiak në këshillin e qarkut.

Ftoj kryetarët e grupeve të bëjnë propozimet përkatëse.

Rolant Xhelilaj : Grupi i Partisë Socialiste për kandidatë të këshillit në këshillin e qarkut propozojmë :

- Z. Alfred Mullaraj
- Zj. Xhiliola Doçi
- Z. Rolant Xhelilaj
- Z. Hekuran Markola
- Zj. Marsida Feshti
- Z. Aldo Çelaj
- Zj. Denisa Luarasi
- Zj. Anila Kapidani
- Zj. Flutura Kasa

Ani Dyrmishi : Faleminderit .
z. Burgija.

Dritan Burgija : Do të kishim propozime nëse do t'i shkonim llogjikës proporciale të realitetit. Ça du të them, në bazë të votave që ka marrë secili koalicion, nëse do shkoj kështu, nëse jo nuk kemi emra për propozim.

Ani Dyrmishi : Rregullorja e përcakton qartë se të gjithë anëtarët përse i përket përfaqësimit në këshillin e qarkut votohen sipas mandateve që ka marrë secila parti.

Dritan Burgija : Ok, nuk kemi propozime.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Atëherë komisioni i votimit të nisë procedurat e votimit përse i përket zgjedhjes së përfaqësuesve të këshillit bashkiak në këshillin e qarkut.

Jonuz Myshketa : Mund të bëjmë dhe ne propozime.

Ani Dyrmishi : Po, po më fal.

Jonuz Myshketa : Propozojmë z. Samet Vata.

Ani Dyrmishi : Faleminderit.

Atëherë komisioni i votimit mori kandidaturat nga kryetari i grupit të Partisë Socialiste dhe kryetari i grupit të Partisë Demokratike. Pesë minuta pushim sa të përgatiten fletët e votimit.

**.... Secili kryetar grupi plotëson procesverbalin me emrat e propozuar prej tyre, që të përgatiten fletët e votimit.....*

**....Nis procesi i votimit përse i përket zgjedhjes së përfaqësuesve të këshillit bashkiak në këshillin e qarkut. Secili këshilltarë firmos, merr fletën e votimit dhe voton. (votimi është i fshehtë).*

**....Në përfundim të votimit komisioni vazhdon punën për numërimin e fletëve të votimit dhe plotësimin e procesverbalit.....*

Klementina Meçi : Atëherë komisioni ka përfunduar detyrën. Kanë votuar 41 këshilltarë, ku 38 janë fletë të vlefshme dhe vetëm 3 prej tyre janë të pavlefshme. Nga numri i votave renditen si më poshtë :

- Z. Alfred Mullaraj 31 vota
- Zj. Xhiliola Doçi 32 vota
- Z. Rolant Xhelilaj 31 vota
- Zj. Denisa Luarasi 31 vota
- Zj. Marsida Feshti 32 vota

- Zj. Flutura Kasa 30 vota
- Z. Aldo Çelaj 32 vota
- Z. Hekuran Markola 31 vota
- Zj. Anila Kapidani 30 vota
- Z. Samet Vata 12 vota

Suksese anëtarëve të ri në këshillin e qarkut.

Ani Dyrmishi : Faleminderit .

Suksese në këtë detyrë.

Këtë mbledhje e deklaroj të mbyllur. Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni nga Sekretaria e Këshillit.

Ju ftoj të bëjmë një foto të gjithë bashkë poshtë te shkallët e bashkisë.

Ky proçesverbal mbyllet me nr. rendor 12 (dymbëdhjetë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.

Mbajtësi i proçesverbalit: Dorina Milja

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit për mbledhjen e parë të konstituimit. :

Kryetar i Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretar i Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Drejtuesi i mbledhjes së parë të këshillit :

ROLANT XHELILAJ

Zëvendëskryetar i Këshillit :

ALNEIDA RROSHI

Zëvendëskryetar i Këshillit :

EDLIRA DEVOLLI